FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2018 – Numri: 14

Tiranë – E martë, 6 shkurt 2018

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 10/2018, datë 1.2.2018	Për mosmiratimin e projektligjit "Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.....	601
Vendim i Kuvendit nr. 11/2018, datë 1.2.2018	Për rrëzimin e listës së dytë në bllok të kandidatëve të përzgjedhur për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë".....	601
Vendim i Kuvendit nr. 12/2018, datë 1.2.2018	Për rrëzimin e listës së dytë në bllok të kandidatëve të përzgjedhur për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë"	601
Vendim i Kuvendit nr. 13/2018, datë 1.2.2018	Për ngritjen e nënkomisionit "Për të drejtat e njeriut", në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.....	602
Vendim i Kuvendit nr. 14/2018, datë 1.2.2018	Për ngritjen e nënkomisionit "Për administratën publike", në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.....	602
Vendim i Kuvendit nr. 16/2018, datë 1.2.2018	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin e Kuvendit nr. 90/2017, "Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të kuvendit", të ndryshuar.....	603
Urdhër i Kuvendit, nr. 1, datë 2.2.2018	Për delegimin e kompetencave.....	603
Dekret i Presidentit nr. 10715, datë 29.1.2018	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	603

Dekret i Presidentit nr. 10716, datë 29.1.2018	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	604
Dekret i Presidentit nr. 10717, datë 30.1.2018	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	604
Udhëzim i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 138, datë 30.1.2018	Për miratimin e treguesve dhe kritereve, të përfshira në kontratën e performancës (model tip), për ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve.....	605
Udhëzim i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 4, datë 31.1.2018	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 20, datë 28.9.2012, "Mbi përcaktimin e standardeve të dokumentit për vërtetimin e sasisë së prodhimit për qëllime të përcaktimit të nivelit të detyrimit të akcizës".....	609
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 2, datë 31.1.2018	Me objekt deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, zotit Besnik Imeraj.....	610
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 2722/2, datë 31.1.2018	Për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksion i oborrit të shkollës "Ali Demi", Vlorë.....	611
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 3052/2, datë 1.2.2018	Për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Sistemim, asfaltim i sheshit midis pallateve në lagjen "Skënder Libohova"", Lushnjë.....	612

VENDIM
Nr. 10/2018

PËR MOSMIRATIMIN E PROJEKTLIGJIT "PËR NJË NDRYSHIM DHE SHTESË NË LIGJIN NR. 69/2012, "PËR SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 38, pika 6, dhe 55 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mosmiratimin e projektligjit "Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar".

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 1.2.2018

VENDIM
Nr. 11/2018

PËR RRËZIMIN E LISTËS SË DYTË NË BLLOK TË KANDIDATËVE TË PËRZGJEDHUR PËR ANËTARË TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR, SIPAS LIGJIT NR. 115/2016, "PËR ORGANET E QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË"

Në mbështetje të pikës 8, të nenit 147 të Kushtetutës dhe të pikës 16, të nenit 35 të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë",

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e listës së dytë në bllok të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, që ka rezultuar nga hedhja e shortit në nënkomisionin "Për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë", si më poshtë:

1. Fatos Lazimi (nga avokatia)
2. Fatmira Luli (nga avokatia)
3. Maksim Qoku (nga trupa e pedagogëve)
4. Mirela Bogdani (nga trupa e pedagogëve)
5. Naureda Llagami (nga shoqëria civile).

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 1.2.2018

VENDIM
Nr. 12/2018

PËR RRËZIMIN E LISTËS SË DYTË NË BLLOK TË KANDIDATËVE TË PËRZGJEDHUR PËR ANËTARË TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË, SIPAS LIGJIT NR. 115/2016, "PËR ORGANET E QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË"

Në mbështetje të pikës 8, të nenit 149 të Kushtetutës dhe të pikës 16, të nenit 35, të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë",

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e listës së dytë në bllok të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, që ka rezultuar nga hedhja e shortit në nënkomisionin "Për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë", si më poshtë:

1. Gëzim Allaraj (nga avokatia)
2. Floreta Gjini (nga avokatia)
3. Eneida Sema (nga trupa e pedagogëve)
4. Gent Ibrahimi (nga trupa e pedagogëve)
5. Andi Muratej (nga shoqëria civile).

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 1.2.2018

VENDIM
Nr. 13/2018

PËR NGRITJEN E NËNKOMISIONIT "PËR TË DREJTAT E NJERIUT", NË PËRBËRJE TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PARLAMENTAR PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 19, pika 2, 21, pika 1, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet nënkomisioni "Për të drejtat e njeriut", në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

II. Fusha e përgjegjësisë së këtij nënkomisioni janë të drejtat e njeriut.

III. Nënkomisioni përbëhet nga 7 anëtarë, si më poshtë:

1.	Vasilika Hysi	Kryetare	(PS)
2.	Enkelejd Alibeaj	Zëvendëskryetar	(PD)
3.	Xhemal Qefalia	Anëtar	(PS)
4.	Eglantina Gjermeni	Anëtare	(PS)
5.	Jurgis Çyrbja	Anëtar	(PS)
6.	Edmond Panariti	Anëtar	(LSI)
7.	Oerd Bylykbashi	Anëtar	(PD)

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 1.2.2018

VENDIM
Nr. 14/2018

PËR NGRITJEN E NËNKOMISIONIT "PËR ADMINISTRATËN PUBLIKE", NË PËRBËRJE TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PARLAMENTAR PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 19, pika 2, 21, pika 1, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet nënkomisioni "Për administratën publike", në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

II. Fusha e përgjegjësisë së këtij nënkomisioni është administrata publike.

III. Nënkomisioni përbëhet nga 7 anëtarë, si më poshtë:

1.	Alket Hyseni	Kryetar	(PS)
2.	Dhurata Çupi	Zëvendëskryetare	(PD)
3.	Klotilda Bushka (Ferhati)	Anëtare	(PS)
4.	Adelina Rista	Anëtare	(PS)
5.	Almira Xhembulla	Anëtare	(PS)
6.	Nasip Naço	Anëtar	(LSI)
7.	Gent Strazimiri	Anëtar	(PD)

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 1.2.2018

VENDIM
Nr. 16/2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 90/2017, "PËR CAKTIMIN E ANËTARËSISË SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 2, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 90/2017, "Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

I. Deputetja Silva Caka caktohet anëtare në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në vend të deputetit Edmond Panariti.

II. Deputeti Dritan Bici caktohet anëtar në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

III. Deputeti Edmond Panariti caktohet anëtar në Komisionin për Politikën e Jashtme.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 1.2.2018

URDHËR
Nr. 1, datë 2.2.2018

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të nenit 28, 29 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i procedurave administrave të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", të ndryshuar

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të institucionit, për Kuvendin e Shqipërisë, te Nëpunësi Autorizues, z. Genci Gjonçaj, Sekretar i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm.

3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I KUVENDIT
Gramoz Ruçi

DEKRET
Nr. 10715, datë 29.1.2018

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c", dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Silvana Isa Kasmi (Dervishi)
2. Bujar Dali Kaca
3. Admir Avdyl Hasanpapaj
4. Ermira Ram Hasanpapaj (Haxhiaj)
5. Agush Latif Saraçi
6. Gesi Ramazan Ali (Aliu)
7. Ardit Sefer Ismaili
8. Zllatko Mitro Matanoviq (Matanaj)
9. Enkeleda Livan Kreka
10. Flavia Besnik Balaj
11. Rezarta Bashkim Borova (Ismalaja)
12. Alban Zydi Muja
13. Guxim Haki Vesho
14. Engjëllush (Engjellush) Ismet Aliaj
15. Gentjan Ziaudin Saraçi (Saraci)
16. Fabiola Besnik Klein (Omuri)
17. Memush Sulo Memushi
18. Xhensiljana Ferdinand Zorn (Mehmeti)
19. Mira (Ermira) Filip Krstović (Popaj)
20. Amarda Fatmir Höller (Çullhaj)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET
Nr. 10716, datë 29.1.2018

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c", dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Enkelejda Vezir Muço
2. Teuta Preng Ndoj (Çela)
3. Alessio Mirash Ndoj
4. Segi Mirash Ndoj
5. Predrag (Dashamir) Stanko Ajković (Hajkoja)
6. Lidra Abdulla Ballhysa
7. Bulina Ferit Basha
8. Taulant Sadik Bërmeta
9. Xhina Bardhyl Schneider (Balaj)
10. Armando Pjetër Rexhepi
11. Devid Alfred Konomi
12. Aldo Qerem Daka
13. Blerina Avdyl Çerkezi
14. Namik Xhevdet Epa
15. Angela Gjovalin Chemam
16. Arion Gëzim Hasko
17. Marsida Luan Muçaku
18. Skënder Nexhip Noni
19. Belfjora Mark Toplana
20. Avenir Njazi Lame
21. Valbona Sali Kërçiku (Sala)
22. Ilda Petrit Peqini
23. Mika Mimiko Buxhuku
24. Sotiraq Koli Mone
25. Klevis Ilirjan Polena

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET
Nr. 10717, datë 30.1.2018

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c", dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, dhe nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e Ministrisë së Kulturës, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe Ministrisë së Drejtësisë,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Egli Krenar Kaja
2. Menduh Rifat Nushi
3. Albina Remzi Hoti
4. Xhelal Mufail Haliti
5. Valmir Xhelil Tertini
6. Shkurte Bilall Fejza Behluli (Fejza)
7. Hajrush Vehbi Behluli
8. Saimir Isa Bajo
9. Albulena Agim Bokshi (Kryeziu)
10. Arben Enver Zharku
11. Jetmir Imer Duraku
12. Kamuran Esad Goranci
13. Fatmir Faik Spahiu
14. Ramadan Dastan Selimi
15. Donjeta Skender Sadiku
16. Besim Hasan Brahimi
17. Latif Tefik Demolli
18. Gent Shkelzen Cakaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

UDHËZIM
Nr. 138, datë 30.1.2018

PËR MIRATIMIN E TREGUESVE DHE KRITEREVE, TË PËRFSHIRA NË KONTRATËN E PERFORMANCËS (MODEL TIP), PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE NË SEKTORIN E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të shkronjës "f", të pikës III, të VKM-së nr. 504, datë 6.7.2016, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve", si dhe VKM-së nr. 504, datë 13.9.2017, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë",

UDHËZOJ:

1. Çdo ofrues i shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve duhet të arrijë treguesit dhe kriteret të përfshira në "Kontratën e Performancës" sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, kontratë që lidhet ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Bashkisë.

2. Bashkia përkatëse, pas nënshkrimit të kontratës së parashikuar në pikën 1 të këtij udhëzimi, nënshkruan një kontratë performance me administratorin e shoqërisë aksionare të ujësjellës-kanalizimeve, ku reflektohen kushtet dhe detyrimet e marra përsipër nga bashkia, në kontratën e nënshkruar sipas pikës 1 të këtij udhëzimi.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve, të gjitha bashkitë, të gjithë shoqëritë aksionare të ujësjellës-kanalizimeve.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Damian Gjiknuri

Lidhja 1

KONTRATË PERFORMANCE

NDËRMJET:
Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve – Bashkia _____
1. Palët bien dakord si më poshtë:
Kjo kontratë performance nënshkruhet sot, më datë _____ midis Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve, më poshtë AKUK, përfaqësuar nga z. _____ me cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm, me adresë rruga "Sami Frashëri", nr. 4, Tiranë, dhe Bashkisë _____, me adresë_____, përfaqësuar nga Kryetarja/i _____.
2. Baza ligjore dhe kohëzgjatja e kontratës
2.1 Kjo kontratë bazohet në ligjin nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", dhe në zbatim të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore"; VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura" dhe VKM-së nr. 504, datë 6.7.2016, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve";
2.2 Kjo kontratë është e vlefshme deri në 31 dhjetor 2018.
2.3 Kjo kontratë ndërtohet duke mbajtur parasysh objektivat strategjikë të qeverisë për sektorin.
3. Qëllimi i kontratës së performancës
3.1 Qëllimi i kësaj kontrate është rritja e cilësisë së shërbimeve ndaj konsumatorëve dhe e përmirësimit të performancës së operatorit të shërbimit të UK-së brenda juridiksionit të bashkisë/bashkive, në funksion të arritjes së objektivave strategjikë, për plotësimin e kërkesave në rritje të të gjithë popullsisë së vendit, për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura.
3.2 Në kushtet e reja të krijuara mbas reformës territoriale dhe administrative dhe për rrjedhojë me zgjerimin e zonës së shërbimit dhe riorganizimit të shoqërive UK, është qëllimi i AKUK që të lehtësojë,

asistojë dhe thellojë bashkëpunimin mes Bashkisë dhe shoqërisë së UK-së për të përmbushur misionin e përbashkët për këto shërbime.

3.3 Kontrata ka gjithashtu për qëllim të forcojë shoqërinë UK për të operuar si një entitet vetadministrues sipas statusit të saj ligjor nën kontrollin e Këshillit Administrativ të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve.

3.4 Palët në këtë kontratë kanë për qëllim që të bashkëpunojnë për të arritur indikatorët e performancës, siç janë përcaktuar në shtojcat, që si më poshtë shoqërojnë këtë kontratë.

4. AKUK, në funksion të përmbushjes së misionit dhe detyrave që ka, merr përsipër:

4.1 AKUK do të koordinojë dhe monitorojë të gjitha aktivitetet sektoriale për sigurimin e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, kanalizimeve dhe trajtimin e ujërave të ndotura, në bashkëpunim me të gjitha institucionet e vendit, në nivel qendror dhe vendor, që të ndihmojë në arritjen e objektivave për të cilat është rënë dakord midis palëve.

4.2 Gjatë planifikimit të nevojave për investime të financuara nga buxheti i shtetit do të kujdeset që këto të fundit të jenë në përputhje me nevojat sipas objektivave të bashkisë dhe planit të biznesit të shoqërisë UK.

4.3 Asiston bashkinë/shoqërinë UK për të hartuar projektpropozimet për investime të financuara nga buxheti i shtetit apo burime të tjera, si dhe monitoron implementimin e tyre. Asiston bashkinë/shoqërinë UK, sipas kërkesës, për të hartuar projektpropozimet për aplikim për kreditim nga bankat e nivelit të dytë, sipas legjislacionit në fuqi, si dhe monitoron implementimin e tyre.

4.4 Miraton të gjithë projektet e ujësjellës-kanalizimeve dhe impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura, të financuara nga buxheti i shtetit, apo institucioneve financiare vendore dhe ndërkombëtare, konsulton dhe siguron asistencë teknike kur kjo kërkohet, për çdo projekt që financohet nga buxheti i Bashkisë, buxheti i sh.a. UK-së, me qëllim garantimin dhe zbatimin e rregullave teknike të projektimit dhe zbatimit.

4.5 Ndjek ecurinë e zbatimit të projekteve në sektor, pavarësisht burimit të financimit, në mënyrë që të sigurohet që projektet të arrijnë rezultatin e projektuar.

4.6 Shpërndan fondin e subvencioneve dhe fondin e financimit për performancë në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe një metodologji transparente, me qëllim përmirësimin e përformancës në shërbimin e shoqërisë UK.

4.7 Përgatit dhe vë në dispozicion manuale të operimit, si dhe udhëzime për hedhjen e të dhënave në programet dhe platformat e monitorimit, si dhe asiston personelin përkatës të ngarkuar nga Bashkia/shoqëria UK, në rastet kur kjo asistencë kërkohet nga Bashkia/shoqëria UK me shkrim ose mjete elektronike për të përmbushur këtë detyrim.

4.8 Vë në dispozicion të shoqërisë UK, manualin/instrumentin për hartimin e planit të biznesit, si dhe asiston/trajnon personelin përkatës të ngarkuar nga Bashkia/shoqëria UK për të hartuar planin e biznesit, në rastet kur kjo asistencë kërkohet nga Bashkia/shoqëria UK.

4.9 Monitoron treguesit e performancës për të cilat është rënë dakord mes palëve.

4.10 Njofton me shkrim kryetarin e Bashkisë dhe ministrin përgjegjës për infrastrukturën, çdo 3 muaj për ecurinë e treguesve të performancës, pjesë e kësaj kontrate.

4.11 Merr në konsideratë gjatë planifikimit të nevojave për trajnim, kërkesat nga Bashkia dhe ose shoqëria UK përkatëse.

4.12 Organizon një grup pune të kualifikuar, i cili ka si funksion të asistojë bashkitë dhe operatorët që të përmbushin treguesit e parashikuar në këtë kontratë.

4.13 Shpërndan fondin sipas performancës për çdo bashki mbi bazën e udhëzimit përkatës në zbatim të ligjit për buxhetin, në shumën e parashikuar për performancë.

5. Bashkia, në përmbushjen e funksionit të saj ligjor për ofrimin e shërbimeve UK merr përsipër:

5.1 Bashkia ka detyrimin që në ushtrimin e funksioneve të veta, të garantojë zbatimin e ligjshmërisë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi për këtë sektor.

5.2 Brenda zonës së juridiksionit të saj, Bashkia është përgjegjëse për dhënien e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura nëpërmjet shoqërisë UK/apo çdo operatori tjetër në pronësi të saj. Zona e juridiksionit të Bashkisë dhe zona e

shërbimit të shoqërisë UK përputhen dhe specifikohen përkatësisht në shtojcën 2 të kësaj kontratë.

5.3 Bashkëpunon dhe kujdeset që fondet e financuara nga AKUK për qëllimin e përmirësimit të performancës të përdoren me eficiencë nga operatori/shoqëria në mënyrë arritjen e qëllimit të kësaj kontratë.

5.4 Miraton planin e biznesit 5-vjeçar të shoqërisë UK, ku janë reflektuar objektivat dhe treguesit për performancën për çdo vit dhe nevoja për mbështetje financiare.

5.5 Me kërkesën e saj, i paraqet AKUK nevojat për investime dhe mbështetje financiare për përmbushjen e objektivave dhe të treguesve për performancën sipas planbiznesit.

5.6 Me kërkesën e saj, i paraqet për miratim AKUK projektet teknike të cilat kanë si synim përmbushjen e objektivave dhe të treguesve të performancës sipas planit të biznesit.

5.7 Rishikon dhe miraton çdo vit planin e biznesit, duke pasur parasysh reflektimin e treguesve të rënë dakord në kontratën me AKUK.

5.8 Paraqet pranë ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën, AKUK dhe Entit Rregullator të Ujit (ERRU), jo më vonë se tre muaj përpara përfundimit të vitit financiar planin e biznesit të rishikuar.

5.9 Merr përsipër që nëpërmjet mekanizmave të kontrollit që disponon, të garantojë që shoqëria nuk do të devijojë nga plani i biznesit.

5.10 Planifikon investime në sektorin UK dhe TUN, brenda kapaciteteve të veta buxhetore, në përputhje me planin e biznesit të miratuar.

5.11 Mbështet shoqëritë UK në procesin e faturimit dhe në mbledhjen e të ardhurave dhe siguron që të gjitha institucionet që operojnë me buxhetin e saj apo varen prej saj të paguajnë në kohë faturat e tyre të shërbimit.

6. Ndryshimet e kontratës

6.1 Ndryshimet në këtë kontratë bëhen me pëlqimin e të dyja palëve dhe janë të vlefshme, pasi bëhen me shkrim dhe firmosen prej tyre.

7. Procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve

7.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë zbatimit të kësaj kontratë janë subjekt negocimi dhe zgjidhen me mirëkuptim midis palëve.

8. Dispozitë përfundimtare

8.1 Kjo kontratë hartohet në tri kopje origjinale, një për secilën pale. Një kopje e kësaj kontrate depozitohet në ERRU.

AKUK
DREJTOR I PËRGJITHSHËM

BASHKIA _____
KRYETAR I BASHKISË

Shtojca 1: Fondi i Bashkisë _____/SHA Ujësjellës-Kanalizime _____ sipas STIP

Emërtimi	**Shuma (lekë)**
Fondi për – performancë	**Sipas buxhetit**
Fondi pa – performancë	**Sipas buxhetit**
Investime me fondet nga buxheti i Bashkisë _____ viti 2018	
Shuma lekë	

Shtojca 2: Lista e aksionarëve të SHA Ujësjellës-Kanalizime _____

Nr.	Bashkia	Përqindja e aksioneve
1	Bashkia_____	
2	Total	

Shtojca 3: Zona e shërbimit të shoqërisë SHA Ujësjellës-Kanalizime _____

Bashkia	Qyteti/Njësia administrative/Fshati
	Total

Shtojca 4: Indikatorët e performancës së aksionit gjatë vitit 2018

1. Rritja e numrit të klientëve të zonës së shërbimit (krahasimi me numrin e njësive sipas projektit të adresarit) sa më poshtë:

- 8 % Për ato që aktualisht kanë mbi 85% të njësive me kontrata;
- 9 % " " 81 % - 84 %
- 10 % " " 77 % - 80 % "
- 11 % " " 73 % - 76 % "
- 12 % " " 69 % - 72 % "
- 13 % " " 65 % - 68 % "
- 14 % " " 60 % - 64 % "

Jo më pak se 74% për ato që aktualisht kanë nën 60%

2. Rritja e shumës monetare të faturimeve për vitin 2018 në të paktën 30% për të gjitha shoqëritë (me çmim reference të vitit paraardhës në rastet kur bashkitë në vitin 2018 do të aplikojnë çmime të ndryshme krahasuar me atë të vitit 2017).

3. Rritja e nivelit të arkëtimeve në masën mbi 95%.

4. Rritja e nivelit të matjes së konsumit të ujit, shprehur nëpërmjet lidhjeve të pajisura me ujëmatës në masën mbi 90%; dhe lidhja e një kontrate kolektive, ose kontratave fikse (me konsumatorët për çezmat e përbashkëta).

5. Reduktimi i kostos së punës dhe asaj të energjisë (së bashku), minimalisht në masën 15%.

6. Arkëtimi i detyrimeve të prapambetura (si referencë 31.12.2017) jo më pak se 30%.

7. Reduktimi i "ujit pa të ardhura" (në fund të vitit 2018) nga:

- aktualisht (deklaruar!) mbi 65% ujë pa të ardhura, jo më shumë se 55% (reale);
- aktualisht (deklaruar!) 55% - 65% ujë pa të ardhura, jo më shumë se 47% (reale);
- aktualisht (deklaruar!) 45% - 55% ujë pa të ardhura, jo më shumë se 40% (reale);
- aktualisht (deklaruar!) 35% - 45% ujë pa të ardhura, jo më shumë se 35% (reale);
- për investimet e 5 viteve të fundit, jo më shumë se 30% (reale);
- për investimet e 2 viteve të fundit, jo më shumë se 20% (reale);

8. Mbulimi i kostos totale të operimit me arkëtimet në nivelin:

- 100% për të gjitha shoqëritë që aktualisht janë në nivelin mbi 80%;
- 90 % " " " " " 60% - 80%;
- 80 % " " " " " nën 60%.

9. Të gjitha shoqëritë, brenda juridiksionit të bashkive përkatëse, duhet të ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë dhe atë të kanalizimeve, njëkohësisht dhe kur është rasti dhe të grumbullimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura.

10. Investime me fondet nga buxheti i bashkive respektive në masën jo më pak se:
- për bashkitë me mbi 30000 kontrata, në masën minimalisht 18 €/lidhje;
- për bashkitë me 20000-30000 kontrata, në masën minimalisht 15 €/lidhje;
- Për bashkitë me nën 20000 kontrata, në masën minimalisht 12 €/lidhje.

11. Vendosja e ujëmatësve funksionalë dhe kalibruar për matjen e sasive të ujit që futet në rrjet, në çdo burim dhe pus-shpime.

12. Miratimi i tarifës së unifikuar brenda zonës së juridiksionit dhe korrektuar sipas parimeve më të mira (në vëmendje rikuperimi kostos), kur është e nevojshme.

13. Lidhja e aktmarrëveshjeve për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura që shoqëria i ka të tretëve.

14. Identifikimi dhe regjistrimi i të gjitha sistemeve të furnizimit me ujë, të ndërtuara nga vetë qytetarët dhe që janë aktualisht funksionale.

15. Ndërtimi i mekanizmave transparentë për furnizimin e familjeve në nevojë me 20 litra/ditë/frymë pa pagesë.

UDHËZIM
Nr. 4, datë 31.1.2018

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 20, DATË 28.9.2012, "MBI PËRCAKTIMIN E STANDARDEVE TË DOKUMENTIT PËR VËRTETIMIN E SASISË SË PRODHIMIT PËR QËLLIME TË PËRCAKTIMIT TË NIVELIT TË DETYRIMIT TË AKCIZËS"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 108, të ligjit 61/2012, "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë" dhe me qëllim përcaktimin e standardeve të dokumentit për vërtetimin e sasisë së prodhimit për përcaktimin e nivelit të akcizës së produkteve të pjesës II, të shtojcës nr. 1, të ligjit 61/2012, "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 20, datë 28.9.2012, "Për përcaktimin e standardeve të dokumentit për vërtetimin e sasisë së prodhimit për qëllime të përcaktimit të nivelit të detyrimit të akcizës" bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

- Në bazën ligjore të udhëzimit, përpara togfjalëshit "në zbatim të nenit 108, të ligjit 61/2012..." shtohet togfjalëshi me përmbajtjen si më poshtë:

"Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,"

-Pika 2 ndryshon me përmbajtjen si më poshtë:

"2. Në rastet e prodhimit në territorin shqiptar të produkteve që i nënshtrohen detyrimit të akcizës dhe niveli i taksimit të të cilave sipas shtojcës 1, të ligjit 61/2012, "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", varet nga sasia e prodhimit faktik të vitit të mëparshëm kalendarik, kjo sasi konfirmohet nga departamenti përgjegjës për akcizat.".

-Pas pikës 2, shtohet pika 2.1 me përmbajtjen si më poshtë:

"2.1. Për qëllime të zbatimit të pikës 2 të këtij udhëzimi, bazuar në përkufizimin e shtojcës nr. 1 "Mallrat e tatueshme me akcizë në Republikën e Shqipërisë", të ligjit 62/12, datë 24.5.2012, "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, "Birrë e bërë nga malto" nga prodhues vendës është produkti përfundimtar "Birrë", që përfitohet si rezultat i kryerjes brenda vendit të proceseve të përpunimit, zierjes dhe fermentimit të lëndës së parë "malto".

- Pas pikës 3 shtohet pika 3.1. me këtë përmbajtje:

"3.1 Në rast të prodhimit të të njëjtit produkt në të njëjtin vend (shtet) prodhues, dokumenti i sasisë së prodhimit duhet të tregojë sasinë e prodhimit të këtij produkti në këtë vend (shtet)." .

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Arben Ahmetaj

VENDIM
Nr. 2, datë 31.1.2018

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“

me sekretare gjyqësore Belma Lleshi, në datën 31.1.2018, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 3, akti, që i përket:

KËRKUES: Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, zoti Bashkim Dedja

OBJEKTI: Deklarimi i mbarimit të mandatit të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, zotit Besnik Imeraj

BAZA LIGJORE: Nenet 127/1/c dhe 127/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 9/1/c dhe 9/2 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, ndryshuar me ligjin nr. 99/2016, datë 6.10.2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatimin e bërë nga kryetari dhe administroi dokumentacionin e çështjes,

VËREN:

1. Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me dekretin nr. 8066, datë 22.3.2013, ka emëruar zotin Besnik Imeraj anëtar të Gjykatës Kushtetuese. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me vendimin nr. 7/2013, datë 1.4.2013, ka dhënë pëlqimin për emërimin e tij si anëtar i Gjykatës Kushtetuese. Më pas, zoti Imeraj ka bërë betimin para Presidentit të Republikës.

2. Në datën 31.1.2018, zoti Besnik Imeraj ka paraqitur kërkesë për heqje dorë nga detyra e gjyqtarit kushtetues për arsye personale e shëndetësore, sipas nenit 127/1-c të Kushtetutës dhe nenit 9/1-c të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 99/2016, si dhe nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

3. Në datën 31.1.2018, Kryetari ka paraqitur para kësaj Gjykate kërkesën për deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, zotit Besnik Imeraj, për shkak se ka dhënë dorëheqjen nga funksioni i anëtarit të Gjykatës Kushtetuese për arsye personale dhe shëndetësore.

4. Në nenin 127/2 të Kushtetutës, si dhe nenin 9/2 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, ndryshuar me ligjin nr. 99/2016, datë 6.10.2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, përcaktohet se mbarimi i mandatit të gjyqtarit deklarohet me vendim të Gjykatës Kushtetuese. Meqenëse dorëheqja është një akt i vullnetshëm dhe shkak kushtetues e ligjor për mbarimin e mandatit të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, atëherë kjo kërkesë për deklarimin e mbarimit të mandatit është e bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 127/1/c dhe 127/2 të Kushtetutës, si dhe të nenit 9/2 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, ndryshuar me ligjin nr. 99/2016, datë 6.10.2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

- Deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, zotit Besnik Imeraj, në datën 31.1.2018, për shkak të heqjes dorë prej tij.
- Njoftimin e këtij vendimi Presidentit të Republikës dhe Kuvendit të Shqipërisë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi menjëherë.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Fatos Lulo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha

KËRKESË
Nr. 2722/2, datë 31.1.2018

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksion i oborrit të shkollës "Ali Demi", Vlorë.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Vlorë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 8,796,650 (tetë milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan shkreli

LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE QË SHPRONËSOHEN NGA PROJEKTI: "Rikonstruksion i oborrit të shkollës "Ali Demi", Vlorë
Çmimi për objektet sipas VKM-së 138, datë 23.3.2000, dhe udhëzimit nr. 3, datë 28.12.2016, i EKB-së Tiranë

NR.	*Z K*	*Nr. i pasurisë*	*Adresa*	*Pronari*	*Sipërfaqe trualli m²*	*Çmimi i truallit lekë/m²*	*Vlera e truallit lekë*	*Sipërfaqe ndërtimi m²*	*Çmimi i ndërtimit lekë/m²*	*Vlera e ndërtimit lekë*	*Vlera totale truall dhe ndërtesë lekë*	*Shënime*
"Rikonstruksion i oborrit të shkollës "Ali Demi", Vlorë												
1	8603	14/104-ND	Vlorë	Dritan Hoxha				70 m² sipas certifikatës së pronësisë			8,796,650	Sipas certifikatës së pronësisë z. Dritan Hoxha ka të hipotekuar 70 m² ndërtesë, e cila është prishur dhe është miratuar leje ndërtimit nr. 5/89, datë 17.8.2010, për objekt polifunksional (social-kulturor) 4-kate me 1- kat nën tokë në lagjen "Dëshmorët", Vlorë. Vlera është përllogaritur me situacion faktik punimesh për fazën e zbatuar të objektit të ndërtuar (kati nën tokë) sipas projektit të zbatimit të miratuar.
								166.05 m² sipas sheshit dhe lejes së miratuar	Situacion punimesh			
Vlera totale e shpronësimit								**8,796,650 lekë**				

KËRKESË
Nr. 3052/2, datë 1.2.2018

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Sistemim, asfaltim i sheshit midis pallateve në lagjen "Skënder Libohova"", Lushnjë.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Lushnjë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", për llogaritjen e vlerës së truallit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është: 358,160 (treqind e pesëdhjetë e tetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli

Vlera e shpronësimit e truallit të z. Pali Trifon Syziu
Në lagjen "Skënder Libohova", zona kadastrale 8572

Investitori Bashkia Lushnjë

Nr.	Nr. i pasurisë	Emër Mbiemër	Zona kadastrale	Lloji i pronës	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera	Konfirmimi nga ZVRPP-ja
1	6/136	Pali Trifon Syziu	8572	Truall	m^2	40	8954	358,160	Shkresa nr. 3376/1 datë 24.4.2017
	Shuma totale							**358,160**	

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë